FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 151

Tiranë – E hënë, 14 nëntor 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 710, datë 11.11.2022	Për disa ndryshime në vendimin nr. 654, datë 14.9.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)", të ndryshuar...	18245
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 711, datë 11.11.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në njësinë mjekësore ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës", të ndryshuar....	18248
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 712, datë 11.11.2022	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion i rrugës 'Ago Çeli' dhe 'Rrugës së Re', si dhe 'Rikonceptimi i palestrës së lagjes '15 Shtatori', Tepelenë".....	18249
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 713, datë 11.11.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 273, datë 6.4.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor 'Unaza Lindore Shkodër"'.....	18252
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 717, datë 11.11.2022	Për shpalljen e "Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik" dhe zhvilluesit të zonës me vendndodhje në Tiranë.....	18254
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 207, datë 28.10.2022	Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për organet e qeverisjes vendore.....	18258

VENDIM
Nr. 710, datë 11.11.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 654, DATË 14.9.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE ORGANIKËS SË AGJENCISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 17, të ligjit nr. 13/2016, "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë", me propozimin Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 654, datë 14.9.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) shtojca I zëvendësohet me shtojcën me të njëjtën numër që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) shtojca II zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Numri i punonjësve të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) të jetë, gjithsej, 165 veta.".

2. Ngarkohet Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



ORGANIGRAMA E AGJENCISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA

		KATEGORIA	POZICIONI
I.	**DREJTOR EKZEKUTIV (TITULLAR I INSTITUCIONIT)**	**II- a**	**1**
	SEKTORI I AUDITIT		**(3)**
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	2
	SEKTORI I KERKIMIT DHE INOVACIONIT/ADISA LAB		**(3)**
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	2
II.	**DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË QENDRAVE**		**(19)**
	DREJTOR	II-b	**1**
	SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE		**(3)**
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	2
	SEKTORI I KOMUNIKIMIT ME QYTETARIN		**(10)**
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	9
	SEKTORI I MBIKQYRJES SË LËVRIMIT TË SHËRBIMEVE		**(5)**
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	4
III.	**DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË BRENDSHËM**		**(16)**
	DREJTOR	II-b	1
	SEKTORI JURIDIK		**(4)**
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	3
	SEKTORI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		**(7)**
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	1
	PUNONJËSE PASTRIMI	I	3
	MAGAZINIER	V	1
	SHOFER	III	1
	SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE PROTOKOLLIT		**(4)**
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	2
	SPECIALIST ARKIV-PROTOKOLL	IV-b	1
IV.	**DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË SHËRBIMEVE**		**(13)**
	DREJTOR	II-b	1
	SEKTORI I RI-INXHINIERIMIT DHE ZHVILLIMIT TË STANDARDEVE		**(4)**
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	3
	SEKTORI I TRAJNIMEVE DHE MENAXHIMIT TË NJOHURIVE		**(3)**
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	2

	SEKTORI I PERFORMANCËS DHE STATISTIKAVE		**(5)**
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	4
V.	**DREJTORIA EKONOMIKE**		**(10)**
	DREJTOR	II-b	1
	SEKTORI I FINANCËS		(3)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	2
	SEKTORI I INVESTIMEVE		(3)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	2
	SEKTORI I PROKURIMEVE		(3)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
	SPECIALIST	IV-a	2
VI.	**ZYRA RAJONALE/VENDORE**		**(100)**
	ZYRA RAJONALE TIRANË		**(10)**
	PËRGJEGJËS ZYRE	III-b	1
	SPECIALIST	IV-b	8
	MIRËMBAJTËS	III	1
	ZYRA VENDORE KAVAJË		**(10)**
	PËRGJEGJËS ZYRE	IV-a	1
	SPECIALIST	IV-c	8
	PUNONJËS PASTRIMI	I	1
	ZYRA RAJONALE FIER		**(18)**
	PËRGJEGJËS ZYRE	III-b	1
	SPECIALIST	IV-b	15
	PUNONJËS PASTRIMI	I	1
	SHOFER	III	1
	ZYRA VENDORE KRUJË		**(8)**
	PËRGJEGJËS ZYRE	IV-a	1
	SPECIALIST	IV-c	6
	PUNONJËS PASTRIMI	I	1
	ZYRA RAJONALE GJIROKASTËR		**(12)**
	PËRGJEGJËS ZYRE	III-b	1
	SPECIALIST	IV-b	9
	PUNONJËS PASTRIMI	I	1
	MIRËMBAJTES	III	1
	ZYRA RAJONALE SHKODËR		**(14)**
	PËRGJEGJËS ZYRE	III-b	1
	SPECIALIST	IV-b	11
	PUNONJËS PASTRIMI	I	1
	SHOFER	III	1
	ZYRA VENDORE MALIQ		**(2)**
	PËRGJEGJËS ZYRE	IV-a	1
	SPECIALIST	IV-c	1
	ZYRA VENDORE LUSHNJE		**(6)**
	PËRGJEGJËS ZYRE	IV-a	1
	SPECIALIST	IV-c	4
	PUNONJËS PASTRIMI	I	1

ZYRA RAJONALE ELBASAN		**(11)**
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	9
PUNONJËS PASTRIMI	I	1
ZYRA RAJONALE KUKËS		**(2)**
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	1
ZYRA VENDORE KAMËZ		**(7)**
PËRGJEGJËS ZYRE	IV-a	1
SPECIALIST	IV-c	5
PUNONJËS PASTRIMI	I	1

VENDIM
Nr. 711, datë 11.11.2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 555, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT MJEKËSOR, TË PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË DHE TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT TEKNIK TË SHKENCAVE MJEKËSORE, NË SISTEMIN E MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR SHËNDETËSINË, NË NJËSINË MJEKËSORE USHTARAKE PRANË SPITALIT UNIVERSITAR TË TRAUMËS, NË STRUKTURAT E TJERA TË FORCAVE TË ARMATOSURA DHE NË INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE DHE SPITALIN PËRKATËS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës", të ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Pas pikës 20 shtohet pika 21, me këtë përmbajtje:

"21. Për një periudhë transitore 2-vjeçare të punës për autonominë spitalore të spitaleve publike, në bashkëpunim me personat e caktuar nga Ministria e Shëndetësisë Turke, pagat e punonjësve turq në pozicionin "Menaxher spitalor" janë të njëjta me pozicionet respektive të punës sipas lidhjes nr. 1/AP.

Përveç pagës sipas lidhjes nr. 1/AP, punonjësit turq në pozicionet "Menaxher spitalor", përfitojnë edhe një shpërblim mujor, në masën e përcaktuar në lidhjen nr. 10.".

2. Në lidhjen nr. 1/AP, në nënndarjen 4, shtohet emërtesa "Menaxher spitalor në spitalet universitare e rajonale".

3. Në lidhjen nr. 10 bëhen këto shtesa e ndryshime:

a) Titulli i lidhjes ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Shpërblimi për punonjësit e personelit të caktuar nga pala turke në Spitalin Rajonal "Memorial" Fier dhe për punonjësit turq në pozicionet "Menaxher spitalor në spitalet universitare e rajonale";

b) Pas nënndarjes 11 shtohet nënndarja 12, me këtë përmbajtje:

12	Menaxher spitalor në spitalet universitare e rajonale	217 900

II. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2022, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2022, për shërbimin spitalor.

III. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 712, datë 11.11.2022

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSION I RRUGËS 'AGO ÇELI' DHE 'RRUGËS SË RE', SI DHE 'RIKONCEPTIMI I PALESTRËS SË LAGJES '15 SHTATORI', TEPELENË"'

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksioni i rrugës 'Ago Çeli' dhe 'Rrugës së Re', si dhe 'Rikonceptimi i palestrës së lagjes '15 Shtatori', Tepelenë"'.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tepelenë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit "truall" dhe "ndërtesë", me një vlerë të përgjithshme prej 14 260 649.10 (katërmbëdhjetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e nëntë pikë dhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit është 14 260 649.10 (katërmbëdhjetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e nëntë pikë dhjetë) lekë dhe përballohet nga llogaria "Fondi i shpronësimeve", në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë justifikues për likuidim pranë Bashkisë Tepelenë, e cila e përcjell dokumentacionin zyrtarisht pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tepelenë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tepelenë për pasuritë e shpronësuara.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, pasqyron në kartelat e pasurive të paluajtshme informacionin për miratimin e shpronësimit për interes publik të pasurive, pronë private, të cilat preken nga realizimi i projektit. Regjistrimi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Tepelenë kryhet pas aplikimit nga Bashkia Tepelenë për shërbimin përkatës.

12. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Tepelenë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lista e shpronësimit të pronarëve të pasurive pronë private që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion i rrugës 'Ago Çeli' dhe 'Rrugës së Re' , si dhe 'Rikonceptim i palestrës të lagjes '15 Shtatori', Tepelenë""

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas ASHK-së TEPELENË)													VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK.	Nr. i pas	Lloji i pas.	Sip. Tot (m^2)	Shpronësime toke "truall"			Ndërtesë jo banimi		Ndërtesë banimi					
								Sip. (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	Sip. nd. konf. nga ZVRPP (m^2)	Vlera sipas Preventivit (lekë)	Sip. nd. konf. nga ZVRPP (m^2)	Çmimi sipas EKB-së (lekë)	Vlera sipas EKB-së (lekë)		
1	Valentina	Ismahil	Muska	3574	14/300	truall+ndërtesë	60	60	1015	60.900	97	2,246,354	0	0	0	2,307,254.00	Objekt 2K SEKSIONI C. Të drejtat reale 27.4.2014 MBI KËTË TRUALL NDODHET NDËRTESA ME NR. PASURIE. 30/60- ND, VOL. 8. FAQE 116 SEKSIONI D. Kufizimet e pronësisë 14.5.2002 LIROHET PASURIA NGA BLLOKIMI NË FAVOR TË BANKËS SË KURSIMEVE SHA; 27.4.2014 NDALOHEN VEPRIMET MBI PASURINË URDHËR KUFIZIMI; 4.7.2017 NË BAZË TË DEKLARATËS NOTERIALE NR. 1554 REP. 882 KOT DATË 28.6.2017 KJO PASURI LIROHET NGA BARRA HIPOTEKORE PËR LLOGARI TË FONDIT BESA SHA; E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN BLERË TRUALLI ME REF 00000275 OBJEKTI LOKAL TREGTAR DY KATE
2	Natasha	Alem	Balili	3574	16/220	truall+ndërtesë	32	32	1015	32,480	32	1,112,798	0	0	0	1,145,278.00	SEKSIONI D. Kufizimet e pronësisë Nuk ka shënime në kartelë
	Gazmend	Zaho	Balili														
	Klodian	Zaho	Balili														
	Marsel	Zaho	Balili														
	Shefiko	Kasëm	Sala	3574	14/307-ND	ndërtesë	50	0	0	0	50	2,035,262	0	0	0	2,035,262.00	SEKSIONI C. Të drejtat reale 27.4.2014 NDËRTESA NDODHET MBI TRUALLIN ME NR. PASURIE. 14/307 VOL. 15 FAQE 32. SEKSIONI E. NË BAZË TË URDHRIT TË REGJISTRUESIT HIQET MASA E KUFIZIMIT MBI PASURI
	Aurora	Maksim	Lazaj														
3	Matilda	Maksim	Çela														
	Anisa	Maksim	Skenderi														
	Albano	Maksim	Sala														
4	Iljaz	Çobo	Qori	3574	16/97	truall+ndërtesë	80	30.9	1015	31,363.50			156	28,320.6	4,418,013.6	4,449,377.10	Objekt 2K SEKSIONI D. Kufizimet e pronësisë 8.7.2016

																	NDALOHEN VEPRIMET MBI PASURINË
5	Aristidh	Sami	Rushiti	3574	16/308	truall	405	30	1015	30,450	0	0	0	0	0.0	30,450.00	SEKSIONI D. Kufizimet e pronësisë 6.7.2016 NDALOHEN VEPRIMET MBI PASURINË
6	Sherif	Çobo	Selimi	3574	14/281	truall+ndërtesë	50	50	1015	50,750	50	1,709,792	0	0	0	1,760,542.00	SEKSIONI D. NUK KA SHËNIME NË KARTELË SEKSIONI E. NUK KA SHËNIME NË KARTELE
7	Edlira	Muha	Jovani	3574	14/14	truall+ndërtesë	30	30	1015	30,450	21.2	939,889	0	0	0	970,339.00	SEKSIONI D. NUK KA SHËNIME NË KARTELË SEKSIONI E. NUK KA SHËNIME NË KARTELË
	Emblika	Myftar	Muha														
	Ilirjan	Xhemo	Muha														
	Manjola	Xhemo	Muha														
	Matilda	Xhemo	Muha														
8	Votim	Xhemal	Asllani	3574	16/309	truall	413	28.5	1015	28,927	0	0	0	0	0	28,927.00	SEKSIONI D. 14.11.2016 BLLOKOHET PASURIA NË FAVOR TË BANKËS POPULLORE PËR SHUMËN 1800000 LEKË; 8.7.2016 BLLOKOHET PASURIA NË FAVOR TË KREDITORIT MANE RUSHITI PËR SHUMËN 2700000 LEKË. KONTRATË; 8.7.2016 MBI KËTË PASURI KA 3 NDËRTIME PA LEJE URDHËR PËR INFORMIM; 06.07.2016 NDALOHEN VEPRIMET MBI PASURINË URDHËR KUFIZIMI; SEKSIONI E: DIFERENCA FAKT-DOKUMENT = 20 m²
9	Pajtim	Lutfi	Ruçi	3574	16/178	truall+ndërtesë	25	25	1015	25,375	25	1,507,845				1,533,220.00	SEKSIONI D. NUK KA SHËNIME NË KARTELË SEKSIONI E. NUK KA SHËNIME NË KARTELË
	Vlera totale e shpronësimit															14,260,649.10	

Shënime.

1. Vlerësimi i tokës truall është llogaritur bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

2. Vlerësimi i objektit "ndërtesë banimi dhe jobanimi" është bërë në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar.

VENDIM
Nr. 713, datë 11.11.2022

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 273, DATË 6.4.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR 'UNAZA LINDORE SHKODËR'"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 273, datë 6.4.2011, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 3 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Sipërfaqja truall prej "… 24 875.6 (njëzet e katër mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë pikë gjashtë) m² …" zëvendësohet me "… 25 014.1 (njëzet e pesë mijë e katërmbëdhjetë pikë një) m² ...".

b) Vlera e përgjithshme e shpronësimit "… prej 243 642 950 (dyqind e dyzet e tre milionë e gjashtëqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekësh …" zëvendësohet me "…prej 244 821 724 (dyqind e dyzet e katër milionë e tetëqind e njëzet e një mijë e shtatëqind e njëzet e katër) lekësh …".

2. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 244 821 724 (dyqind e dyzet e katër milionë e tetëqind e njëzet e një mijë e shtatëqind e njëzet e katër) lekësh, përballohet, si më poshtë vijon:

a) Vlera 243 642 950 (dyqind e dyzet e tre milionë e gjashtëqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë, "Fondi i shpronësimeve";

b) Vlera 1 178 774 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë përballohet nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.".

3. Tabelës bashkëlidhur vendimit në fuqi i shtohet tabela, bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Shpenzimet procedurale, në vlerën prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh, përballohen nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.

III. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në "Fletoren zyrtare" dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

IV. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE PËRFUNDIMTARE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 273, DATË 6.4.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR 'UNAZA LINDORE SHKODËR"'

Nr.	Pronari			ZK	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe totale e pronës. m2	Të dhënat e pasurisë				VLERA TOTALE (Lek)	Adresa e pronarit	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri				Sip. m^2	Çmimi m^2	Vlera në lek	Lloji i pasurisë			
1	Nike	Lulash	Lufaj	8593	12/443	274	48.5	8511	412,784	Truall	412,784	Bashkia Shkodër	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Gjyzepina	Zef	Toma	8593	12/461	300	90	8511	765,990	Truall	765,990	Bashkia Shkodër	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Luigj	Mati											
	TOTALI						**138.5**		**1,178,774**		**1,178,774**		

VENDIM
Nr. 717, datë 11.11.2022

PËR SHPALLJEN E "ZONËS SË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK" DHE ZHVILLUESIT TË ZONËS ME VENDNDODHJE NË TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 9, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, "Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik", të ndryshuar, të ligjit nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 14/1, të vendimit nr. 646, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave e të kritereve të përzgjedhjes së zhvilluesit në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen "Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik" (TEDA), Tiranë, të territorit me sipërfaqe 342 185 m^2 (treqind e dyzet e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë) m^2, pjesë të zonave kadastrale nr. 3866, nr. 2105 dhe nr. 1867, në Tiranë, të përbërë nga parcelat me numrat e pasurive dhe sipërfaqet përkatëse, sipas listës dhe genplanit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Shtrirja, kufijtë, pikat e hyrjes e të daljes së "Zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik" (TEDA), Tiranë, përcaktohen në genplanin, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Veprimtaritë, që do të zhvillohen në "Zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik" (TEDA), Tiranë, janë të llojit:

a) industria e automobilave;
b) industria e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (ICT);
c) industria e pajisjeve elektronike;
ç) industria farmaceutike;
d) industria agropërpunuese;
dh) industritë prodhuese;
e) industri të tjera në përputhje me legjislacionin shqiptar.

4. Periudha e funksionimit të "Zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik" (TEDA), Tiranë, është 35 vjet, me të drejtë përsëritjeje deri në 99 vjet.

5. Zhvillues i "Zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik" (TEDA), Tiranë, shpallet Bashkia Tiranë.

6. Masat mbështetëse të përfituara nga Bashkia Tiranë, si subjekt përfitues i statusit "Investim/investitor, procedurë e veçantë", bazohen në vendimin nr. 1/8, datë 15.7.2021, të Komitetit të Investimeve Strategjike.

7. Për pjesët e sipërfaqes së "Zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik" (TEDA), Tiranë, që janë pronë private, të bëhet shpronësimi dhe/ose kompensimi, sipas ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar.

8. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

ZONA TEKNOLOGJIKE E ZHVILLIMIT EKONOMIK (TEDA) TIRANË,
GENPLAN I ZONËS



LISTA E PASURIVE ZONA E TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK "TEDA", TIRANË

Nr.	Zona kadastrale	Nr. i pasurie	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja m²	Statusi
1	3866	116/10	Arë	4200	Shtet
2	3866	116/11	Arë	4200	Shtet
3	3866	116/12	Arë	5281	Privat
4	3866	116/13	Arë	947	Shtet
5	3866	116/17	Arë	5750	Privat
6	3866	116/19	Arë	5000	Privat
7	3866	116/2	Arë	8000	Privat
8	3866	116/20	Arë	4000	Privat
9	3866	116/21	Arë	4200	Shtet
10	3866	116/23	Arë	2100	Privat
11	3866	116/24	Arë	2100	Privat
12	3866	116/25	Arë	2100	Privat
13	3866	116/26	Arë	2200	Privat
14	3866	116/29	Arë	5337	Privat
15	3866	116/3	Arë	5550	Privat
16	3866	116/30	Arë	7585	Shtet
17	3866	116/31	Arë	2500	Shtet
18	3866	116/32	Are	4585	Shtet
19	3866	116/33	Rrugë	829	Shtet
20	3866	116/34	Arë	850	Shtet
21	3866	116/35	Arë	3750	Shtet
22	3866	116/37	Arë	3800	Privat
23	3866	116/38	Arë	512	Shtet
24	3866	116/39	Arë	1624	Privat
25	3866	116/4	Arë	6655	Shtet
26	3866	116/40	Arë	163	Shtet
27	3866	116/5	Arë	1980	Shtet
28	3866	116/6	Arë	6000	Privat
29	3866	116/8	Arë	4200	Shtet
30	3866	116/9	Arë	8000	Privat
31	3866	181/2	Arë	11000	Privat
32	3866	181/27	Arë	3700	Privat
33	3866	181/28	Arë	6500	Privat
34	3866	181/29	Arë	4500	Privat
35	3866	181/32	Arë	3700	Privat
36	3866	181/34	Arë	800	Privat
37	3866	181/35	Arë	2300	Privat
38	3866	181/51	Arë	4000	Privat
39	3866	181/52	Are	4000	Privat
40	3866	181/53	Arë	2000	Privat
41	3866	181/54	Arë	3300	Privat
42	3866	181/56	Arë	2200	Shtet
43	3866	181/57	Arë	6500	Privat
44	3866	181/58	Arë	5000	Privat
45	3866	181/59	Arë	3000	Privat
46	3866	181/60	Arë	1700	Privat
47	3866	181/61	Arë	5950	Shtet
48	3866	181/62	Arë	3000	Privat
49	3866	181/68	Arë	1200	Privat
50	3866	181/69	Arë	3800	Privat
51	3866	181/72	Arë	8300	Shtet
52	3866	181/3	Arë	5300	Privat
53	3866	368/14	Kanal	2179	Shtet

54	3866	504	Rrugë	1798	Shtet
55	3866	606	Kanal	1663	Shtet
56	3866	607	Kanal	2553	Shtet
57	3866	608	Rrugë	2541	Shtet
58	3866	609	Kanal	2062	Shtet
59	1867	103	Kanal	953	Shtet
60	1867	104	Rrugë	2300	Shtet
61	1867	105	Kanal	1682	Shtet
62	1867	23/1	Arë	11000	Privat
63	1867	23/10	Arë	2550	Privat
64	1867	23/11	Arë	1507	Privat
65	1867	23/12	Arë	6000	Privat
66	1867	23/17	Arë	5800	Privat
67	1867	23/18	Arë	3900	Privat
68	1867	23/19	Arë	5600	Privat
69	1867	23/20	Arë	1600	Privat
70	1867	23/21	Arë	3900	Privat
71	1867	23/22	Arë	3600	Privat
72	1867	23/23	Arë	3100	Privat
73	1867	23/24	Arë	2300	Privat
74	1867	23/27	Arë	1000	Privat
75	1867	23/28	Arë	1500	Privat
76	1867	23/29	Arë	9700	Privat
77	1867	23/3	Arë	5100	Privat
78	1867	23/31	Arë	1500	Privat
79	1867	23/32	Arë	500	Privat
80	1867	23/5	Arë	6000	Privat
81	1867	23/6	Arë	3000	Privat
82	1867	23/7	Arë	5750	Privat
83	1867	23/8	Arë	4050	Privat
84	1867	23/9	Arë	2550	Privat
85	2105	562/1	Arë	10000	Privat
86	2105	562/10	Arë	1037	Privat
87	2105	562/11	Arë	1037	Shtet
88	2105	562/3	Arë	486	Shtet
89	2105	562/4	Arë	6760	Privat
90	2105	562/5	Arë	3097	Shtet
91	2105	562/6	Arë	2078	Shtet
92	2105	562/7	Kanal	630	Shtet
93	2105	562/8	Arë	1037	Privat
94	2105	562/9	Arë	1037	Privat
			TOTAL	**342185**	

UDHËZIM
Nr. 207, datë 28.10.2022

PËR PROCEDURAT E HARTIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 50, të Kodit Zgjedhor nr. 10019, datë 29.12.2008, i ndryshuar, të dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore",

UDHËZOJ:

1. Brenda datës 7.11.2022, nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGJC) i vitit 2010, të gjenerohet ekstrakti elektronik i përbërësve zgjedhorë, në përbërje të të cilit janë të gjithë shtetasit me të drejtë vote, të lindur që nga data 14.5.2005, të cilët deri në datën e zhvillimit të zgjedhjeve, më 14.5.2023, mbushin 18 vjeç.

2. Ekstraktet e përbërësve zgjedhorë dhe lista e zgjedhësve gjenerohen në përputhje me procedurën e parashikuar në udhëzimin nr. 225, datë 11.5.2016, të ministrit të Punëve të Brendshme, "Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin, parashikuar nga ligji nr. 138/2015 'Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"'.

3. Grupimin e listës së zgjedhësve sipas zonave të qendrave të votimit, kufijtë e të cilave janë ato të zgjedhjeve të fundit. Kryetari i bashkisë, i cili ka marrë njoftimin brenda 48 orëve nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile në bashki/njësi administrative, se ka qendra votimi me më pak se 300 (treqind) zgjedhës, apo qendra votimi me më shumë se 1 000 (një mijë) zgjedhës, vendos për bashkimin dhe/ose ndarjen e qendrave të votimit, sipas kërkesave të kriterit numerik dhe cakton adresën e qendrës së votimit.

4. Në rastin e institucioneve të posaçme (burgjet, vendet e paraburgimit, si dhe spitalet ose institucionet e tjera shëndetësore, që pranojnë pacientë për më shumë se tri ditë), limiti i poshtëm për qendrën e votimit i referohet një numri prej 15 (pesëmbëdhjetë) zgjedhësish.

5. Për rastet e qendrave të votimit me fraksion që kalojnë limitin numerik të përcaktuar në Kodin Zgjedhor, kryetari i bashkisë vendos për rindarjen e tyre, duke u nisur nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve të qendrës së votimit bazë. Numri i përgjithshëm i një qendre votimi, me gjithë fraksionet e saj, ndahet në pjesë të barabarta, me jo më shumë se 1000 (një mijë) zgjedhës secila.

6. Për qendrat e votimit me më pak se 300 (treqind) zgjedhës, kryetari i bashkisë vendos për bashkimin e kësaj qendre me një qendër më të afërt dhe me mundësi komunikimi rrugor, ku numri i përgjithshëm i zgjedhësve duhet të jetë mbi 300 (treqind) zgjedhës. Nëse numri i përgjithshëm i zgjedhësve për qendrat që bashkohen rezulton të jetë më shumë se 1 000 (një mijë) zgjedhës, atëherë kryetari i bashkisë pas bashkimit të këtyre qendrave vendos ndarjen me fraksion të qendrës së votimit të krijuar, sipas pikës 5, të këtij udhëzimi. Nëse dy a më shumë qendra votimi kanë më pak se 300 (treqind) zgjedhës, qendra/qendrat me numër më të vogël zgjedhësish i bashkohen atyre me numër më të madh zgjedhësish.

7. Vendimet e kryetarit të bashkisë për ndarjen ose bashkimin e qendrave të votimit, si dhe ndryshimet e adresave të qendrave të votimit nëse ka të tilla, i dërgohen në formë shkresore për zbatim zyrës së gjendjes civile në bashki/njësi administrative, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në Ministrinë e Brendshme, si dhe për dijeni Prefektit të Qarkut përkatës, jo më vonë se 5 ditë nga marrja e informacionit nga zyra e gjendjes civile.

8. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile kryen veprimet përkatëse brenda 24 orëve me marrjen e vendimit të kryetarit të bashkisë, për ndarjen e qendrave të votimit.

9. Ky informacion mund të ndryshohet deri në orën 24:00 të së njëjtës ditë. Në rast të mos realizimit të ndryshimeve, nga Regjistri Kombëtar ekzekutohet automatikisht kërkesa për ndarjen e qendrës së votimit sipas kriterit numerik dhe mbiemrit të zgjedhësit. Qendrat e votimit me fraksion marrin automatikisht adresën e qendrës bazë. Në rast se kryetari i bashkisë vendos që adresa e qendrës së votimit të jetë e ndryshme nga adresa e qendrës bazë, përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile kryen veprimet për korrigjimin e adresës së qendrës së votimit.

10. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile në bashki/njësi administrative me marrjen e vendimit të kryetarit të bashkisë për bashkimin e dy a më shumë qendrave të votimit, kryen veprimet përkatëse brenda 24 orëve. Ky informacion mund të ndryshohet deri në orën 24:00 të së njëjtës ditë. Në rast të mos realizimit të ndryshimeve, nga Regjistri Kombëtar ekzekutohet automatikisht kërkesa për bashkimin e qendrave të votimit në bazë të vendimit të kryetarit të bashkisë.

11. Procedurat e parashikuara në pikat 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9, të këtij udhëzimi, kryhen për çdo ekstrakt të listës së zgjedhësve.

12. Në rast se kryetari i bashkisë nuk përmbush detyrimet e parashikuara sipas pikave 3, 4, 5 dhe 6 të këtij udhëzimi, deri në publikimin e ekstraktit të fundit para publikimit të listës përfundimtare të zgjedhësve, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, kryen menjëherë ndarjen dhe/ose bashkimin e qendrave të votimit sipas kritereve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, të cilat reflektohen në listat përfundimtare të zgjedhësve të datës 14.5.2023.

13. Brenda datës 22.11.2022, zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative, printojnë ekstraktin e parë të përbërësve zgjedhorë të të gjithë zgjedhësve, sipas vendbanimit dhe qendrave të votimit, nën juridiksionin e tyre territorial dhe pasi ky ekstrakt firmoset nga kryetari i bashkisë, publikohet në ambientet e bashkive/njësive administrative në vende të aksesueshme për publikun.

Ekstraktet e përbërësve zgjedhorë me të njëjtat kritere, printohen dhe publikohen në mënyrë periodike sipas përcaktimeve në Kodin Zgjedhor, jo më vonë se në datat 22.12.2022, 21.1.2023, 20.2.2023, 22.3.2023 dhe 4.4.2023.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile publikon ekstraktet e përbërësve zgjedhorë, në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Brendshme. Me publikimin e ekstraktit të radhës, ekstrakti i mëparshëm fshihet.

14. Brenda 60 ditëve nga publikimi i ekstraktit të parë, kryetari i bashkisë kryen njoftimin me shkrim të zgjedhësve të përfshirë në ekstraktin e printuar, sipas qendrave të votimit nën juridiksionin e territorit të bashkisë përkatëse. Njoftimi për shtetasit është sipas modelit nr. 1, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi i cili gjenerohet nga sistemi.

a) brenda këtij afati, kryetari i bashkisë njofton për arsyen e mos përfshirjes në listë për shtetasit me moshë mbi 100 vjeç, njoftimi për të cilët realizohet nëpërmjet formularit, sipas modelit nr. 2, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi; si dhe

b) brenda këtij afati, kryetari i bashkisë përmes drejtuesit të institucioneve të posaçme, njofton shtetasit që kanë mbushur moshën e të drejtës së votimit, por që këtë të drejtë e kanë humbur si pasojë e të qenit subjekt i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", i ndryshuar. Njoftimi për këta shtetas realizohet nëpërmjet formularit, sipas modelit nr. 3, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

15. Zgjedhësit, të cilët kanë marrë njoftimin me shkrim nga ana e bashkisë dhe konstatojnë se në përbërësit e tyre zgjedhorë ka pasaktësi, i drejtohen zyrës së gjendjes civile përkatëse për të bërë rregullimet e mundshme.

16. Të drejtën për kërkesë për korrigjimin e qendrës së votimit e kanë dhe shtetasit që kanë mbushur moshën 100 vjeç. Këta shtetas do të bëjnë kërkesë për ndryshimin e qendrës së votimit nga 8899 (numërtim i vendosur nga sistemi vetëm për këtë grup zgjedhësish), në qendrën e votimit sipas vendbanimit të tyre. Kjo kërkesë realizohet sipas modelit nr. 4, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

17. Krahas ndryshimit të përbërësve zgjedhorë në rrugë administrative, zyra e gjendjes civile në bashki/njësi administrative pasqyron edhe rastet e vendimeve të gjykatave, deri në ditën e printimit të listës së zgjedhësve.

18. Më datë 4.4.2023, çdo zyrë e gjendjes civile në bashki/njësi administrative, printon listën e zgjedhësve nga Regjistri Kombëtar dhe firmos për çdo qendër votimi, duke përfshirë edhe institucionet e posaçme, nën juridiksionin territorial të saj dhe ia dorëzon kryetarit të bashkisë.

19. Brenda datës 4.4.2023, kryetari i bashkisë miraton dhe firmos listën dhe e dërgon në të tre formatet e parashikuara në Kodin Zgjedhor, në KZAZ-të përkatëse.

20. Jo më vonë se 10 ditë pas shpalljes së listës së zgjedhësve, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, i dërgon Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave një kopje të listës në format elektronik.

21. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi kryetarët e bashkive, Drejtoria e Përgjithshme e

Gjendjes Civile, nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashki/njësi administrative, si dhe institucionet e tjera shtetërore të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

Modeli 1

NJOFTIMI I ZGJEDHËSVE

Qarku: _____

Bashkia: _____ / Njësia Administrative _____

Numri banesës: _____

Të nderuar,

Z./Znj. <Emri> < emri i babait ><mbiemri>, datëlindja< __ / __ / ___ >,Numri rendor në listë:<nr>
Z./Znj. <Emri> < emri i babait ><mbiemri>, datëlindja< __ / __ / ___ >,Numri rendor në listë:<nr>
Z./Znj. <Emri> < emri i babait ><mbiemri>, datëlindja< __ / __ / ___ >,Numri rendor në listë:<nr>

Ju njoftojmë se për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, që do të zhvillohen më datë 14.05.2023, jeni të regjistruar në listën e qendrës së votimit numër <Nr QV>, me adresë: <Adresa QV>

KRYETARI I BASHKISË

_____
(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

Datë:__ / __ / _____

Modeli 2

NJOFTIMI I ZGJEDHËSVE ME MOSHË MBI 100 VJEC NË DATËN E VOTIMIT

Qarku:_____

Bashkia:_____

Numri banesës:_____

I/e nderuar/a Z./Znj. _____

Ju njoftojmë se për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore që do të zhvillohen më datë 14.05.2023, në mbështetje të nenit 51 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si shtetas që keni mbushur moshën 100 vjeç, nuk jeni të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të qendrës së votimit.

Sipas nenit 53 të Kodit Zgjedhor, për t'u përfshirë në listën e zgjedhësve, duhet t'i drejtoheni me kërkesë zyrës së gjendjes civile ku rezultoni i regjistruar.

KRYETARI I BASHKISË

_____

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

Modeli 3

NJOFTIM I KRYETARIT TË BASHKISË PËR ZGJEDHËSIT, TË CILËVE U HIQET E DREJTA E VOTIMIT PËR SHKAK TË QËNIES SUBJEKT I LIGJIT NR.138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTERGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN , EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"

Bashkia: _____,

Emërtimi i Institucionit: _____

I/e nderuar/a Z/Znj. _____

Ju njoftojmë se për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore që do të zhvillohen më datë 14.05.2023, në mbështetje të gërmave "a" dhe "b" , të pikës 1 të nenit 2, të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", në cilësinë e subjektit të këtij ligji, nuk rezultoni i përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të qendrës së votimit.

KRYETARI I BASHKISË

_____

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

Datë:__/__/_____

MODELI 4

KËRKESA E ZGJEDHËSIT ME MOSHË MBI 100 VJEC NË DATËN E VOTIMIT PËR T'U PËRFSHIRË NË LISTËN E ZGJEDHËSVE

K Ë R K E S Ë

Bashkisë _____ / Njësisë Administrative _____

Zyrës së Gjendjes Civile: _____

_____

Unë i nënshkruari _____ banor në Bashkinë _____ / Njësia Administrative _____, pasi mora njoftimin e kryetarit të bashkisë, se nuk jam i përfshirë në listën e zgjedhësve për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore që do të zhvillohen më datë 14.05.2023, paraqes këtë kërkesë, për t'u përfshirë në listën e zgjedhësve të qendrës së votimit Nr. _____, ku rezultojnë të regjistruar dhe anëtarët e tjerë të familjes / ku kam vendbanimin.

(Emër, Mbiemër)

_____

(nënshkrimi)

Datë: ____ / ____ /_____

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2022 - Numri: 151
Datë: 2022/11/14 16:00:51
4100b694-f1b6-4918-98e6-fabfbd3cf208

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë